



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Koraunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



Drejtoria për Administratë të Përgjithshme
Uprava za Opštu Administraciju
Directory of General Administration



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

Raporti vjetor i punës për periudhën Prill - Dhjetor 2022

III. Nr. prot. 05 Br. prot. 05
Më Dt. 04.01.2023
RAHOVEC - ORAHOVAC

Në raport janë paraqitur aktivitetet dhe punët që janë kryer, bazuar në planifikimin, objektivat dhe detyrat e punës të Zyrtarit për Barazi Gjinore.

- * Raportim në sistemin SMPK për Performancë komunale, për pjesën e Barazisë Gjinore.
- * Pjesëmarrës në takim në tryezën e rrumbullaket në emër të projektit Kujdesi Shëndetësor i Qasshëm dhe Cilësor (AQH). Qëllimi i takimit "Roli i gjinisë në sektorin e shëndetësisë dhe praktikat e shëndetit publik.
- * Plotësimi i Plani i veprimit PKBGJ monitorimi 2022, për komunën e Rahovecit.
- * Nga data 24.04.2022 deri me 01.06.2022 pjesëmarrës në aplikimin e Pagesave Direkte - Subvencione, në Krushë e Madhe.
- * Plotësim i të dhënave për pjesën e Barazisë Gjinore për raportim në KAB 2023 – 2025.
- * Vizitë në Kooperativën Bujqësore "Krusha", në Krushë e Madhe me ftesë të ambasadorit Tomas Szunyog shef i Zyres së Bashkimit Evropian, së bashku me kryetarin.
- * Pjesëmarrës në tryezën e rrumbullakët me temën "E drejta e grave për trashëgimi në pronë" organizuar nga Sh.P.G "Hareja" në bashkëpunim me Organizatën "Prosperiteti" nga Gjakova dhe Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim në Rahovec.
- * Plotësim i Pyetësorit për punonjësit komunalë - Çmimit Evropian të Ekselencës në Qeverisje në Kosovë.
- * Pjesëmarrja në trajnim dy ditorë organizuar nga Demos dhe Helvetas me temën: Angazhimi institucional në procesin e organizimeve të dëgjimeve buxhetore.
- * Pjesëmarrës në punëtorin dy-ditore "Mbështetja e Zyrtarëve Komunal për Barazi Gjinore në sigurimin e politikave të ndjeshme gjinore dhe adresimin efektiv të rasteve të dhunës në familje", organizuar nga Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE).
- * Pjesëmarrës në mbledhjen e pestë (5) të rregullt të KKS-së.
- * Marrja pjesë në trajnim dy ditorë 13-14 Shtator organizuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) në bashkëpunim dhe koordinim nga UNDP, qëllimi i trajnimit ka forcimin e ndërtimit të kapaciteteve profesionale për të siguruar qeverisje efektive në promovimin e të drejtave të njeriut.
- * Pjesëmarrës në punëtorin si antarë i Grupit Punues për zhvillimin, popullimin dhe menaxhimin e një "databaze" për konsultime publike, organizuar nga Helvetas/ Demos.

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Administratë të përgjithshme

* Pjesëmarrës në takimin e mbajtur nga Agjencia për Barazi Gjinore/ZKMF me Zyrtarë për Barazi Gjinore në nivel qendror dhe lokal.

Gjatë pjesës së parë të takimit është bërë prezantimi i draft-raportit të monitorimit dhe vlerësimit të arritjes së caceve për indikatorët dhe zbatimi i aktiviteteve të planit të veprimit të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore, ndërsa, pjesa e dytë e takimit u diskutua për aktivitetet që do të realizohen për 16 Ditë të Aktivizmit.

* Kyqja online përmes Zoom në takimin konsultativ i nivelit të lartë, me temë

“Pjesëmarrja e Grave në Tregun e Punës”, organizuar nga Agjencia për Barazi Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit në bashkëpunim me Qendrën Kosovare për Studime Gjinore.

* Kryesues i Komisionit për Vlerësimin e Pronës Komunale për Këmbim me pronën private në zonën kadastrale Rahovec, ku komisioni ka bërë vlerësimin e dy parcelave.

* Marrja pjesë në ligjeratë ndërgjegjësimi kundër kancerit të gjirit në QKMF "Dr. Fahredin Hoti" organizuar nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në kuadër të fushatës “Tetori Rozë”.

* Takim pune në zyre me zyrtaren nga USAID Maria Berishaj Sylejmani dhe me kryetaren e grupit joformal të grave, qëllimi i takimit ishte lidhur me projektin e USAID “Përmirësimi i sistemit të qeverisjes së pronës”.

* Pjesëmarrës në ligjeratën vetëdijësuese për parandalimin e kancerit të gjirit, organizuar nga grupi jo formal i grave dhe zyra për barazi gjinore, në Shoqatën e Gruas “Hareja” në kuadër të fushatës “Tetori Rozë”.

* Takim pune në zyre me zyrtaren e Njesisë për të drejtat e njeriut në MBPZHR, temat me rendësi që u diskutuan gjatë takimit ishin: E drejta në pronën e përbashkët; Zgjerimi i masave afirmative për regjistrim të pronës në emër të dy bashkëshortëve; Ligji për mbrojtjen e femijes, punët e rrezikshme të femijeve në bujqësi dhe pylltari.

Aktivitetet i zhvilluam në teren për të parë fuqizimin e gruas në zona rurale.

* Pjesëmarrës në tryezën e rrumbullakët, të organizuar nga OSBE, lidhur me “Sfidat në hartimin e buxheteve komunale dhe buxhetin e përgjegjshëm gjinor”.

* Pjesëmarrës në takim në shoqatën e Gruas “Hareja”, organizuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) ku ka filluar implementimin e projektit Gjinia, Paqja dhe Siguria. Ky projekt synon të adresojë kërcënimet dhe rreziqet me të cilat përballen gratë në komunitet si dhe dhunën në familje në përgjithësi.

* Pjesëmarrës në mbledhjen e rregullt të KKS-së.

* Marrja pjesë në punëtorinë për implementimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë – KOMF dhe Zyra për Qeverisje të mirë në kuadër të zyrës së Kryeministrit. Qëllimi i kësaj punëtorie ishte fuqizimi i kapaciteteve të profesionistëve përgjegjës për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, duke mundësuar ofrimin e shërbimeve cilësore dhe të qëndrueshme për fëmijët.

* Takim pune në zyre me Inspektorë të Agjencisë për Informim dhe Privatësi, pasi që si punë shtesë me vendim të kryetarit jam emruar, Zyrtar për mbrojtjen e të dhënave personale.

Qëllimi i takimit ishte marrja e informatave për numrin e kamerave në qytet.

* Pjesëmarrja në takim të organizuar nga OJQ-ja “Advancing Together” në bashkëpunim me Misionin e UNHCR-së në Kosovë dhe Agjencionin për Ndihmë Juridike Falas, me temë: “Fuqizimi i kordinimit institucional në ndihmën juridike falas për të kthyerit dhe të zhvendosurit”, qëllimi i

KOMUNA RAHOVEC

takimit ishte që të adresojmë sfidat e të kthyerve dhe të zhvendosurve brenda vendit në qasje në shërbimet për ndihmë juridike falas.

- * Marrja pjesë në Konferencën, ku u lansua Raporti Vjetor mbi Zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, organizuar nga zyra për qeverisje të mirë.

- * Pjesëmarrës në seancat e Kuvendit Komunal.

- * Pjesëmarrës në trajnim e organizuar nga USAID në qendrën rinore ShL-Kosova, me temën: Institucionet e Drejtësisë, roli i tyre në mbrojtjen e të drejtave të grave dhe qasja në shërbimet e drejtësisë.

- * Aktivitet në kuadër të fushatës "16 ditë aktivizëm kundër dhunës në baza gjinore", Policia e Kosoves - Rahovec së bashku me Zyrtarin për Barazi Gjinore mbajtën takim informues me nxënësit e SHFMU "Bekim Sylka" në Rahovec, po ashtu për nxënësit u shpërndanë edhe fletushka për vetëdijësim kundër dhunës në familje.

- * Marsh paqësor në kuadër të fushatës "16 ditë aktivizëm kundër dhunës në baza gjinore", organizuar nga grupi jo formal i grave të Kuvendit Komunal.

- * Pjesëmarrës në aktivitetin në palestrën sportive "Mizahir Isma" me fëmijët me nevoja të veçanta me moton "Të gjithë jemi të barabartë", organizuar nga shoqata "Hareja" në bashkëpunim me DKRS.

- * Marrja pjesë në seancë pune organizuar nga USAID për t'i shënuar 16 ditë aktivizmi kundër dhunës me bazë gjinore, me temën: Si mund ta zvogëlojnë të drejtat pronësore rrezikun nga dhuna me bazë gjinore, pjesëmarrës ishin komunat e Rahovecit, Lipjanit, Ferizajt, Suharekës, Pejës.

- * Pjesëmarrës në mbledhjen e KKSB-së.

- * Pjesëmarrës në shoqatën e gruas "Hareja" në përmbylljen e aktiviteteve të vitit 2022

- * Plotësim i Plani gjithpërfshirës i komunave për përmbylljen e obligimeve të agjendës evropiane Janar-Dhjetor 2022, si punë shtesë i autorizuar me vendim të kryetarit, Zyrtar për Integritet Evropian.

Alban Gashi



**Zyrtar për Barazi Gjinore
Komuna Rahovec**

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Administratë të përgjithshme